

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-58/13

Prishtinë,

10 dhjetor 2013

Në çështjen juridike të

L.A

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

kundër

H/H

Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Gjyqtarët: Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Dag Brathole dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/149/2012 (lënda është regjistruar në AKP me numrin 34140), të datës 19 prill 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 10 dhjetor 2013, mori këtë

AKTGJYKIM

- 1- Refuzohet si e pabazuar ankesa e L.A kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/149/2012, i datës 19 prill 2012, në lidhje me lëndën e regjistruar në AKP me numrin KPA34140.**

- 2- Konfirmohet vendimi KPCC/D/C/149/2012, i datës 19 prill 2012, për sa i përket lëndës së regjistruar me numrin KPA34140.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Me 16 janar 2007 L.A ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku ka kërkuar posedimin e pronës komercialë-ngastrave kadastrale: 1057/2, 1059/4, 1059/8 dhe 1059/9, të identifikuar në Fletën Poseduese 1119 në vendin e quajtur “Fusha-Te Rasatniku” Zona Kadastrale Podujevë, në Komunën e Podujevës.
2. Në kërkesë deklarohet se I.M është uzurpuesi i pronës. Ai nuk ka paraqitur përgjigje në kërkesë. H.H i është përgjigjur kërkesës, duke vepruar si kryefamiljar i familjes së SH.I. KKPK-ja e ka regjistruar H.H si palë përgjegjëse.
3. Me 19 prill 2012 KKPK-ja hodhi poshtë kërkesën e L.A, duke thënë se është jashtë juridiksionit të KKPK-së sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK/REG/2006/50 e amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-079 (tani e tutje: Ligji Nr. 03/L-079).
4. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar L.A me 27 dhjetor 2013. Ajo kundërshtoi vendimin me 17 janar 2013. Ankesa iu dorëzua H.H me 17 korrik 2013. Ai nuk dha përgjigje në ankesë brenda afatit prej 30 ditëve.
5. Lënda është pranuar nga Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme me 30 tetor 2013.
6. Aleksic-i deklaroi në kërkesë se ajo ia kishte shitur një pjesë të pronës kontestuese SH.I në vitin 1998. Një pjesë tjetër e pronës, e përbërë prej 10 ari, ia kishte shitur I.M në ndërkohë. Kontrata të brendshme për shitblerje janë arritur në mes të palëve, dhe ata hynë në shtëpi kur L.A u largua nga shtëpia në vitin 1999. L.A pretendon se ka pranuar vetëm gjysmën e çmimit të shitjes nga I.M. Ky fakt nuk është kontestuar në këtë lëndë.

Argumentet e palëve

7. L.A deklaroi në ankesë se nuk e konteston pronësinë e SH.I, i cili e ka blerë pronën nga ajo në vitin 1998. Kjo ishte evidente edhe nga kërkesa që ajo ka paraqitur në AKP. Sidoqoftë, ajo pohon se I.M, i cili kishte blerë 10 ari të pronës, ka paguar vetëm gjysmën e çmimit të blerjes. Kërkesa dhe kontesti janë të lidhur vetëm me këtë ngastër. Ajo tani kërkon ri-posedimin e 10 ari të cilët ia kishte shitur I.M. KKPK-ja nuk e ka trajtuar këtë kërkesë, dhe emri i I.M nuk përmendet në vendimin e saj. Ndërsa L.A ka kërkuar pagesën e pjesës së mbetur të borxhit në KKPK-ë, ajo po kërkon ri-posedimin e pronës në Gjykatën Supreme.
8. H.A ka kërkuar pronësinë ndaj pronës kontestuese në emër të SH.I, në KKPK-ë. Ai nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Arsyetim ligjor

9. Ankesa është e pranueshme, pasi është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh të paraparë në nenin 12.1 të Rregullores të Ligjit Nr. 03/L-079.
10. Gjykata Supreme vëren se L.A ka deklaruar në kërkesë, dhe e ka sqaruar në vijim në ankesën e saj se kërkesa e saj është e drejtuar kundër I.M, dhe jo kundër SH.I. Gjykata Supreme konsideron se do të ishte normale nëse KKPK-ja do të komentonte lidhur me këtë fakt.
11. Sidoqoftë, Gjykata Supreme pajtohet me KKPK-në se kërkesa nuk është nën juridiksion të KKPK-së dhe të Gjykatës Supreme.
12. Sipas nenit 3.1 të Rregullores, KKPK-ja ka kompetencë që të zgjidh kërkesat që ndërlidhën drejtpërsëdrejti me rrethanat ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Kështu që, paraqitësi i kërkesës nuk duhet vetëm të ofrojë dëshmi rreth pronësisë ndaj pronës së paluajtshme por gjithashtu edhe të tregojë pamundësinë e tij të ushtrojë atë të drejtë pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhën drejtpërsëdrejti ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur.
13. Në këtë rast L.A konfirmon se pronën kontestuese ia kishte shitur SH.I si dhe një ngastër të pronës I.M. L.A nuk ka asnjë çështje të pazgjidhur me SH.I, dhe se kontesti me I.M ka të bëjë me mos pagesën e gjysmës së çmimit të shitjes. Si rrjedhojë, kontesti nuk është i ndërlidhur me konfliktin e armatosur të viteve 1998/1999, dhe se KKPK-ja nuk ka juridiksion ndaj kësaj lënde.

14. Prandaj, Gjykata Supreme konfirmon vendimin e KKKP-së dhe refuzon ankesën si të pabazuar.

Këshillë juridike:

15. Sipas nenit 13.6 të Ligjit Nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete të rregullta ose të jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Dag Brathole, Gjyqtar i EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Holger Engelmann, Referent i EULEX-it